

VENDIM
Nr. 14, datë 16.1.2019

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ANËTARËVE TË BORDIT TË PËRZGJEDHJES,
TË KOMISIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT KALIMTAR TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS DHE TË SHËRBIMIT PËR
ÇËSHJTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME
DHE TË SEKRETARIATIT TEKNIK PRANË KËTIJ KOMISIONI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e trajtimit financiar për disa nga organet e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme, të cilat janë:

- a) Bordi i Përzgjedhjes së Anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit;
- b) Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit;
- c) Sekretariati teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

2. Shpërblimi për anëtarët e Bordit të Përzgjedhjes të jetë në masën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, i cili jepet pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe të anëtarëve të sekretariatit teknik përkatës.

3. Paga për anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të jetë në masën 190 000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4. Paga për anëtarët e sekretariatit teknik të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit të jetë në masën 110 000 (njëqind e dhjetë mijë) lekë në muaj.

5. Për mbulimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në buxhetin e Ministrisë së Brendshme miratuar për vitin 2019 shtohet fondi në vlerën 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI